



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM ERZEN –TIRANË

Nr ___prot

5302/5

Tiranë më 24/12/2018

VENDIM

NR. 37 DATË. 04/12/2018

PËR

**MOSMIRATIMIN E KËRKESËS PËR “MIRATIMIT NË PARIM PËR PËRDORIM TË
BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE, NGA HEC IBA,
SUBJEKTIT “AB70-KONSTRUKSION” SH.P.K.**

Në zbatim të ligjit nr 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, përkatësisht të nenit 42 pika 3; neni 50, pika 2, neni 52 gërma c; të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme ,dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimi për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore” si dhe të, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedura ve të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, neni 24, gërma “f”, m ndryshuar me VKM nr. 718 datë 12.10.2016” Me propozim të A.B.U Ishëm Erzen për paisjen me autorizim miratim në parim të subjektit “**AB70-KONTRUKSION**” SH.P.K. Këshilli i Basenit Ujor Ishëm Erzen ,

KONSTATOISE,

Bazuar në të dhënat e paraqitura në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti, rezulton se disa objekte të “Hec IBA” do të ndërtohen brënda zonës së mbrojtur, kategoria II Park Kombëtar “Mali i Dajtit” i shpallur me VKM nr.402 datë 21.06.2006 “Për shpalljen e ekosistemit natyror të malit të Dajtit” .Në zonën ku është projektuar vepra e marrjes së Hec IBA ndodhet dhe monumenti i natyrës “gryka e Skoranës” e shpallur nga VKM NR.676 datë 20.12.2002 “Për shpalljen e mbrojtur të monumenteve të natyrës”(Sipas Raportit të Vlerësimit të ndikimit në mjedis paraqitur nga subjekti).

Për këto arsye, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm - Erzen,

V E N D O S I:

1-Mosmiratimin e kërkesës për “miratimin në parim për përdorim të burimit ujqor për energji elektrike nga Hec Iba” subjektit “**AB70-KONSTRUKSION**” sh.p.k., me administrator **Z.Arben Banushaj**, për përdorim të burimit ujqor në rrjedhën e sipërme të lumit Erzen, në fshatin Ibë, Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë, me këto të dhëna:

- Koordinatat e veprës së marrjes X – 44 14 129 Y – 45 70 136 Z- 310
- Godina e centralit me koordinata X- 44 09 373 Y- 45 67 843 Z- 190
- Prurja mesatare: Q mes 4,113 m³/sek;
- Prurja ekologjike: Q₃₅₅= 0.320 m³/sek;
- Prurja që shkarkohet: Q_{lllog}= 2.760 m³/sek.
- Fuqia e instaluar E= 1960 KW
- Sasia e ujit që do të lihet për Bujqësinë Q_{vaditëse}=0.200 m³/sek

2-Kjo kërkesë nuk është miratuar për arsyet e mëposhtme:

- Ndërtimi i “Hec Iba” bie në zonë të mbrojtur, në zonën ku është projektuar vepra e marrjes së Hec Iba ndodhet dhe monumenti i natyrës “Gryka e Skoranës”

3- Ngarkohet A.B.U. Ishëm-Erzen për zbatimin e ketij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi mbas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHEM ERZEN

SEKRETAR

Dorina CAPUNI



KRYETAR

Suzana JAHOLLARI

